

# SFIDAT E MATJES SË MIGRACIONIT NË SHQIPËRI

MAJLINDA NESTURI, INSTITUTI I STATISTIKAVE  
mnesturi@instat.gov.al

## Abstrakt

Emigrimi është një nga arsyet kryesore për rënien e popullsisë në Shqipëri. Duke qenë se emigrantët shqiptarë nuk regjistrohen sistematikisht kur largohen nga vendi dhe për shkak se ka pasur pak stimuj për të regjistruar largimin e tyre me autoritetet lokale, përdorimi i "metodave indirekte" ishte mënyra e mundshme për të prodhuar një vlerësim të individëve që kanë emigruar midis viteve 2001 dhe 2011. Sipas vlerësimeve indirekte të INSTAT-it, gjatë kësaj periudhe rreth 481.000 shqiptarë u larguan nga vendi. Për sa i përket të kthyerve, të dhënat e Cesusit treguan se rreth 139.827 shqiptarë u kthyen në vend gjatë 2001-2011. "Metodat indirekte" të përdorura për llogaritjen e migracionit neto ndihmojnë për të pasur një vlerësim të migracionit për periudhën midis dy Censuseve, ku pas Censurit të fundit INSTAT përdori anketën e Forcave të Punës. Migrimi mbetet komponenti kryesor që udhëheq ndryshimet e popullsisë. Për këtë arsye, matja e tij është sfida kryesore me të cilën përballemi gjatë llogaritjes së popullsisë vjetore.

## 1. MIGRACIONI NDËRKOMBËTAR

Migrimi ndërkombëtar ka qenë një forcë e madhe në ndryshimin e popullsisë në dy dekadat e fundit. Arsyeja kryesore për rënien e popullsisë në dy censuset e fundit ishte emigrimi në shkallë të gjerë i qytetarëve shqiptarë. Në Shqipëri, si në vende të tjera, migrimi veçanërisht përfshin të rinjtë, të cilët migrojnë për arsye punësimi, mundësi arsimimi dhe për arsye familjare. Rrjedhimisht, të rinjtë figurojnë veçanërisht në statistikat e migracionit dhe kanë qenë kontribuuesit kryesorë në rënien e popullsisë në Shqipëri.

Emigrimi ishte arsyeja kryesore për rënien e popullsisë në Shqipëri para vitit 2001 dhe në periudhën 2001-2011. Zhdukja e barrierave ndaj emigracionit dhe trazirave sociale në vitet 1990 krijoi valë të njëpasnjëshme të emigracionit në këto vite. Disa qindra mijëra shqiptarë u larguan nga vendi (Carletto et al. 2006), një humbje që nuk u kompensua nga imigracioni dhe rritja natyrore. Ky emigrim masiv ishte shkaku kryesor i ndryshimit të plotë, nga një rritje e lartë vjetore e popullsisë, në periudhën e censuseve 1979-1989 prej 2,0%, me një rritje negative (-0.3 për qind në vit) në periudhën pasuese të censuseve 1989-2001. Në terma absolutë, rritja e popullsisë prej pothuajse 600 mijë personave, që u vëzhgua në periudhën midis censuseve para vitit 1989, u shndërrua në një rënie prej më shumë se 100 mijë në atë pas vitit 1989. Censusi i vitit 2011 përfundimisht tregoi se emigrimi ishte faktori më i rëndësishëm në humbjen neto të popullsisë prej 269 mijë personave në periudhën 2001-2011, duke përbërë 8,8% të popullsisë së vitit 2001. Sipas vlerësimeve indirekte të INSTAT-it, gjatë kësaj periudhe rreth 482 mijë shqiptarë u larguan nga vendi, një numër që u kompensua pjesërisht nga imigracioni dhe rritja natyrore.

Një pjesë e shpjegimit të vazhdimet të emigracionit mund të kërkohej në ndryshimin e karakteristikave të emigracionit shqiptar. Mendohet se gjatë viteve 1990 migrimi u dominua nga burrat e rinj, të cilët kërkonin punë jashtë vendit, në një kohë kur Shqipëria ishte në trazirë. Në dekadën e parë të këtij mijëvjeçari, migrimi duket të jetë i larmishëm; migrimi është ende i dominuar nga të rriturit e rinj, por përveç burrave janë edhe gratë ato që zgjedhin të largohen jashtë vendit. Pjesa e fëmijëve është rritur disi dhe ky është një tregues i qartë i procesit të ribashkimit familjar dhe migrimit të martesës, që shpesh ndjek migrimin e valës së parë të mbizotëruar nga meshkujt. Një proces i tillë i ribashkimit familjar dhe migrimit të martesës tenton të mundësojë nivele të larta të migrimit të

vazhdueshëm, të paktën për disa vite pas valës së parë të migrimit.

### 1.1 EMIGRACIONI - METODA INDIREKTE

Emigrimi është një nga arsyet kryesore për rënien e popullsisë në Shqipëri midis viteve 2001 dhe 2011. Duke qenë se banorët shqiptarë nuk regjistrohen sistematikisht kur largohen nga vendi dhe për shkak se ka pak nxitje për të regjistruar një largim me autoritetet lokale, nuk ka matje të besueshme të numrit të individëve që janë larguar nga Shqipëria. Megjithatë, është e mundur që të përdoren metoda indirekte për të prodhuar një vlerësim të individëve të cilët kanë emigruar midis periudhës 2001 dhe 2011. Kjo metodë e tërthortë konsiston në krahasimin e të dhënave nga të dy censuset, atë të vitit 2001 dhe 2011. Gjatë asaj dekade, popullsia e Shqipërisë u ul me 8,8 përqindje, pra nga 3.1 milionë në 2.8 milionë. Për të vlerësuar se deri në çfarë mase emigrimi i jashtëm ishte përgjegjës për këtë rënie, u llogarit popullsia e mbyllur pas censurit të vitit 2001 (Migracioni në Shqipëri, 2014 ).

Në hapin e parë u mor si bazë popullsia sipas moshës dhe gjinisë në 1 janar 2001. Në hapin e dytë, u mor informacioni për lindjet e gjalla sipas gjinisë për çdo vit. Ndërsa në hapin e tretë, u mor numri i vdekjeve sipas moshës dhe gjinisë, i llogaritur duke përdorur normat specifike të vdekjeve, bazuar në parashikimet e popullsisë të censurit të vitit 2001 (Projeksionet e Popullsisë për Shqipërinë, INSTAT, 2004). Për secilën moshë, numri i vdekjeve u zbrit nga popullsia në vitin 2001. Për popullsinë e moshës zero, numri i lindjeve të gjalla në vitin paraparak u mor në konsideratë. Kjo procedurë pastaj u përsërit për çdo vit deri në janar 2012.

Procedura e përshkruar llogarit një popullsi të mbyllur e cila nuk merr parasysh migracionin. Për të llogaritur numrin e emigrantëve është e nevojshme, si një hap i ardhshëm, të krahasohet popullsia e mbyllur e llogaritur më lart me popullsinë e censurit. Së pari, popullsia e mbyllur, vlerësuar më 1 janar 2012, u ekstrapolua deri më 1 tetor 2011 për t'u përputhur me popullsinë e census në të njëjtën datë (1 tetor 2011). Diferenca midis këtyre popullsisë të vlerësuar dhe popullsisë së census 1 tetor 2011 është migracioni i vlerësuar neto.

## 1.2 MIGRIMI I KTHIMIT

Duke pasur parasysh numrin e lartë të shqiptarëve që jetojnë jashtë vendit, migrimi i kthimit nuk ka qenë shumë i dukshëm. Megjithatë, në censusin e vitit 2011, më shumë se 100 mijë persona u raportuan se ishin kthyer nga qëndrimi jashtë vendit, që prej vitit 2001. Analiza e migracionit nga censusi tregoi se kthimet kanë qenë në rritje çdo vit, veçanërisht pas vitit 2008 (Migrimi në Shqipëri, 2014).

Ndërsa disa prej këtyre migrantëve të kthyer zhvendosen në Shqipëri përgjithmonë, për shumë prej tyre kthimi është i përkohshëm në natyrë. Në këtë kuptim, migracioni i kthimit i kapur në census është një pjesë e migracionit qarkullues. Për më tepër, shifrat e migracionit bazohen në përkufizimin e pranuar ndërkombëtarisht, ku emigrant konsiderohet dikush që qëndron jashtë vendit për të paktën një vit.

## 2. VËSHTIRËSITË PËR MATJEN E FLUKSEVE TË MIGRACIONIT

Migracioni vazhdon të jetë një fenomen i rëndësishëm për shumë vende në botë, duke ndikuar si vendet origjinë, ashtu edhe ato pritëse. Shumë pak dihet për numrin vjetor aktual të migrantëve në të gjithë botën dhe informacioni i pakët në dispozicion është kontradiktor. Sot, vendet bazohen në përkufizimet e tyre se çfarë nënkuptohet me 'migracion'. Kjo krijon mospërputhje për të dhënat ndërkombëtare dhe është sfidë për të kuptuar procesin me anë të të cilit personat lëvizin përtej kufijve.

Shpesh është theksuar se informacioni statistikor mbi migracionin është i pamjaftueshëm dhe jo i plotë sa i përket disponueshmërisë, harmonizimit të koncepteve, përkufizimeve dhe saktësisë. Është gjerësisht e njohur se të dhënat e migrimit nuk janë të lehta për t'u mbledhur dhe se sistemet e mbledhjes së të dhënave, si dhe përkufizimet e përdorura për të përcaktuar ngjarjet e migrimit, ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme.

Kështu, përputhshmëria e të dhënave me flukset migratore janë të nevojshme për një sërë arsyesh, të cilat janë kritike për zhvillimin e një evidence të besueshme mbi politikën e migracionit dhe kërkimet. Një nga vështirësitë kryesore është mungesa e një përkufizimi standard për matjen e flukseve migratore. Gjithashtu, e nevojshme është që të dhënat të shkëmbehen midis vendeve origjinë dhe pritëse, si dhe të përgatiten procedurat për vlerësimin e flukseve migratore të raportuara. Në rastin shqiptar, matja e flukseve të migracionit

është sfida kryesore. Siç u prezantua më lart, të vetmet të dhëna në dispozicion për migrimin ishin censusi i popullsisë dhe banesave në Shqipëri, i cili jep një vlerësim në lidhje me stokun e migracionit brenda periudhës midis censureve. Siç dihet, duke përdorur censuset për matjen e migracionit ka vështirësi ose kufizime. Censusi i Popullsisë dhe Banesave kryhet çdo 10 vjet, përmban vetëm një numër të vogël pyetjesh dhe nuk mund të numërojë të gjitha ngjarjet e migrimit si familje të tëra që lëvizin, migrimin sezonal/ të përkohshëm dhe qarkullues. Prandaj, censusi nuk mund të përbëjë një burim statistikash vjetore mbi migracionin ndërkombëtar. Për më tepër, në mungesë të burimeve të të dhënave administrative, INSTAT u përpoq të bazohet në anketat sociale si anketa e Forcave të Punës Tremujore. Gjithashtu, INSTAT po vlerëson mënyra të reja për matjen e migracionit, duke marrë parasysh eksperiencat e vendeve të tjera. Këto mënyra konsistojnë në mundësinë e kryerjes së një ankete specifike dhe përdorimin e statistikave pasqyrë. Statistikat pasqyrë, shkëmbimi i të dhënave midis vendeve origjinë dhe pritëse, do të ishin një zgjidhje në rast se do të kishim përkufizim të harmonizuar, si dhe procedura të përcaktuara për vlerësimin e flukseve të raportuara.

## 3. MATJA E MIGRACIONIT DUKE PËRDORUR ANKETËN E FUQISË PUNËTORE

Anketa tremujore e Forcave të Punës është një studim i bazuar në njësitë ekonomike familjare. Të gjithë individët e moshës 15 vjeç e lart në njësitë ekonomike familjare të përzgjedhur janë subjekt i anketës së fuqisë punëtore. Kampioni përzgjidhet në bazë të procedurës së kampionimit me dy faza. Në vitin 2014, për herë të parë, në anketën tremujore të AFP-së u përfshi një modul i ri për matjen e migrimit të brendshëm, ndërkombëtar dhe të rikthyer. Ky informacion përmes këtij moduli mblidhet në baza tremujore, por të dhënat përpunohen dhe publikohen në bazë vjetore.

Moduli i ri për migracionin është përfshirë në pyetësorin e AFP-së në vitin 2014, i cili ishte një pilot për të kontrolluar nëse gjithçka funksiononte. Sipas APF 2014, të dhënat e mbledhura nga ky modul kishin disa probleme; numri i emigrantëve ishte i nënvlerësuar (shumë i ulët), ndërsa në anën tjetër të kthyerit u kapën më mirë. Në vitin 2014, pyetjet në lidhje me migracionin morën si referencë vitin 2011, në mënyrë që të mbulohej e gjithë periudha e pas cesusit, ndërsa në vitin 2015 pyetjet vazhduan duke konsideruar vetëm gjendjen krahasuar me një vit më parë, e kështu

vazhdoi edhe për vitet në vijim. Ky modul është inkorporuar në roster-in e pyetësorit, që mbledh disa informacione bazë për të gjithë anëtarët e NjEF-së dhe jo vetëm për ata që janë objekt i anketës. Përgatitjet e të dhënave konsistojnë në disa procedura dhe kontrole, të cilët më pas do të përdoren për llogaritjen e popullsisë më 1 janar. Cilësia e të dhënave të mbledhura ka ardhur vazhdimisht duke u përmirësuar dhe mbulimi është më i plotë në të dyja anët, si për emigrantët, ashtu edhe për të kthyerit.